

MARRËVESHJA GJITHËPËRFSHIRËSE

ndërmjet

REPUBLIKËS SË KOSOVËS

dhe

REPUBLIKËS SË SERBISË

Dhjetor 2018

Përmbajtja

Preambula.....	3
Kapitulli 1: Marrëveshja politike	5
Kapitulli 2: Masat për ndërtimin e besimit	7
Kapitulli 3: Garancitë dhe mbrojtjet e të drejtave të njeriut	8
Kapitulli 4: Ekonomia.....	13
Kapitulli 5: Drejtësia Tranzicionale dhe Pajtimi.....	16
Kapitulli 6: Arsimi dhe rinia.....	19
Kapitulli 7: Simbolet kombëtare.....	20
Kapitulli 8: Asociacioni i komunave me shumicë serbe	21
Kapitulli 9: Transporti	22
Kapitulli 10: Energjia.....	23
Kapitulli 11: Zbatimi i marrëveshjeve të Brukselit.....	24
<i>Kapitulli 12: Mekanizmat zbatues dhe monitorues</i>	<i>27</i>
Kapitulli 13: Ndryshimet në Kornizën ligjore	28
Kapitulli 14: Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve sipas kësaj Marrëveshje	29
Kapitulli 15: Njohja dhe Anëtarësimi në Organizata Ndërkombëtare	30
Kapitulli 16: Hyrja në fuqi	31

Preambula

Republika e Kosovës dhe Republika e Serbisë (në tekstin e mëtutjeshëm “Palët”)

- *Duke njohur* vullnetin e popujve të të dy shteteve që të arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e përhershme dhe e detyrueshme mes Palëve, e cila siguron paqe, prosperitet dhe marrëdhënie harmonike midis dy shteteve;
- *Duke njohur* përgjegjësinë e Palëve për t'i zgjidhur çështjet e pazgjidhura në interes të sigurisë dhe prosperitetit të rajonit dhe të bashkësisë ndërkombëtare në përgjithësi;
- *Duke njohur* që Marrëveshja për Çështjet e Sukesionit (2001) e nënshkruar nga shtetet trashëgimtare të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ofron një kornizë për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve të caktuara analoge për Palët;
- *Duke riafirmuar* aspiratat e Palëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior, si dhe në organizata të tjera ndërkombëtare, siç është rasti për Kosovën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara;
- *Duke pasur parasysh* nevojën për të promovuar dhe zbatuar një proces gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm në aspektin gjinor sa i përket pajtimit dhe reparacionit për t'u marrë me të kaluarën;
- *Duke pasur parasysh* të drejtën legjitime të Republikës së Serbisë për të avokuar për të drejtat e komunitetit serb që jeton në Republikën e Kosovës;
- *Duke njohur* që e drejta për vetëvendosje në situata ku një popull i ndryshëm është i shtypur ose ku qeveria e shtetit të mëparshëm nuk përfaqëson në mënyrë legjitime interesat e atij populli është e mbrojtur qartë në të drejtën ndërkombëtare;
- *Duke njohur* se është parim i së drejtës ndërkombëtare që shtetet sovrane të sapoformuara duhet t'i kenë të njëjtit kufij që kishin para pavarësisë, në kohën kur ishin zona të varura;
- *Duke njohur* që Propozimi Gjithëpërfshirës i vitit 2007 për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës arriti në përfundim se Kosova duhet të krijohet si shoqëri shumetnike që respekton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore;
- *Duke njohur* opinionin këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë se shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare;

- *Duke riafirmuar* detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e lehtësuara nga Bashkimi Evropian lidhur me normalizimin e marrëdhënieve;
- *Duke pranuar* interesat legjitime të bashkësisë ndërkombëtare që të sigurohet zbatimi i kësaj Marrëveshjeje dhe respektimi i saj;
- *Duke riafirmuar* zotimet që i kanë bërë Palët në përputhje me Marrëveshjet e tyre përkatëse me Bashkimin Evropian për Stabilizim dhe Asociim.

Përmes kësaj bien dakord që të kenë detyrime ligjore lidhur me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Kapitulli 1: Marrëveshja politike

Palët hyjnë në këtë Marrëveshje duke vërtetuar solemnisht se do t'i përmbahen, do t'i mbështesin dhe do t'i japin efekt të plotë kuptimeve dhe parimeve të mëposhtme:

- 1.1 Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë kërkon një qasje *sui generis* dhe strukturat që pasqyrojnë interesat e tyre të përbashkëta si dhe identitetet kulturore të qytetarëve të tyre.
- 1.2 Secila Palë ka përgjegjësi të veçantë që t'i respektojë, shërbejë dhe mbrojë interesat e personave që banojnë në shtetin e tyre por identifikohen me shtetin tjetër në bazë të fesë, përkatësisë politike ose përkatësisë etnike.

Prandaj, bien dakord si në vijim:

- 1.3 Palët bien dakord që secila prej tyre është shtet sovran dhe i konstituuar në mënyrë të ligjshme.
- 1.4 Palët bien dakord të mbështesin njëra-tjetrën në avancimin e interesave të tyre përkatëse si anëtare të organizatave ndërkombëtare dhe mbi-kombëtare, përfshirë edhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara në rastin e Kosovës.
- 1.5 Palët zotohen për bashkëpunim politik, ekonomik dhe social, nëpërmjet strukturave qeveritare dhe joqeveritare, për t'i mbrojtur dhe promovuar interesat e të gjithë popujve të të dy shteteve.
- 1.6 Palët në politikën dhe praktikën e tyre do të udhëhiqen nga nevoja për të promovuar një frymë të paqes, tolerancës dhe respektimit ndërkulturor dhe ndërfetar si dhe dialogut mes të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, brenda juridiksionit të tyre.
- 1.7 Palët riafirmojnë zotimin e tyre për partneritet dhe bashkëpunim ndërkombëtar.
- 1.8 Palët do të ofrojnë mekanizma efektive për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut të të gjithë qytetarëve të të dy shteteve.
- 1.9 Palët zotohen të krijojnë struktura të përbashkëta për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të pazgjidhura që rrjedhin nga lufta e viteve 1998-1999, përfshirë këtu reparacionet, personat e zhdukur, krimet e dhunës seksuale dhe krimet e luftës.

- 1.10 Palët bien dakord që parimi i Paritetit të Vlerësimit (*Parity of Esteem*) do t'i udhëheqë marrëdhëniet e tyre të ardhshme.
- 1.11 Palët bien dakord për vendosjen e strukturave të përhershme jo-ekzekutive dhe ndërqeveritare të cilat do të synojnë të trajtojnë tërësinë e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve.
- 1.12 Palët bien dakord që të zbatojnë çfarëdo dispozite ligjore që është e nevojshme për t'i dhënë efekt të plotë statutor dhe kushtetues kësaj Marrëveshjeje.
- 1.13 Palët bien dakord që për zgjidhjen e çështjeve të caktuara të suksesionit t'i referohen dhe të udhëhiqen nga parimet e Marrëveshjes për Çështjet e Suksesionit (2001) të nënshkruar nga shtetet trashëgimtare të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, përveç kur këto parime zëvendësohen nga Marrëveshjet e Brukselit ose nga marrëveshjet e tjera të arritura.

Kapitulli 2: Masat për ndërtimin e besimit

1. Palët zotohen të sigurojnë mbështetje ligjore, institucionale, financiare dhe programore në ndërtimin e besimit ndërmjet komuniteteve në shtetet përkatëse.
2. Palët zotohet të krijojnë një fond të përbashkët për të ofruar mundësi për studiuesit në nivelin akademik, hulumtuesit dhe të rinjtë, në mënyrë që të marrin pjesë në shkëmbimin ndërkufitar në fushën e arsimit, kulturës, artit dhe sportit.
3. Palët zotohen të krijojnë programe të përbashkëta universitare dhe të ofrojnë mundësi për bursa dhe “*fellowship*” për t’ia mundësuar studentëve të njërit shtet të studiojnë në universitetet e shtetit tjetër në fushën e interesit të tyre.
4. Palët bien dakord që në institucionet e arsimit publik në Republikën e Kosovës të zhvillohen kurse gjuhësore në *shqip* dhe në *serbisht*, përfshirë edhe në institucionet arsimore që funksionojnë me kurrikulën arsimore serbe në Republikën e Kosovës.
5. Palët bien dakord të themelojnë *Shoqatën e Bizneseve Kosovë-Serbi* për t’ia mundësuar ndërmarrjeve publike dhe atyre private që t’i trajtojnë shqetësimet e përbashkëta dhe t’i zvogëlojnë barrierat për të bërë biznes përtej kufijve.
6. Palët bien dakord të krijojnë programe bashkëpunimi ndërkufitar në kuadër të programeve ekzistuese të Ballkanit Perëndimor të mbështetura nga Bashkimi Evropian.
7. Palët bien dakord të krijojnë programe bashkëpunimi ndër-komunal dhe projekte të binjakëzimit për t’u mundësuar komunave të promovojnë turizmin ndër-komunal, të mbështesin zhvillimin ekonomik lokal dhe të fuqizojnë bashkëpunimin në fushën e bujqësisë.

Kapitulli 3: Garancitë dhe mbrojtjet e të drejtave të njeriut

Zotimet e përgjithshme

1. Palët janë të vetëdijshme se të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë, pa diskriminim, në mbrojtje të barabartë sipas ligjit.
2. Palët zotohen që parimet e mos-diskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit do të zbatohen dhe respektohen në veçanti sa i përket punësimit në administratën publike dhe në ndërmarrjet publike, dhe sa i përket qasjes në shërbimet publike dhe në financimin publik.
3. Palët bien dakord të promovojnë paqen, tolerancën si dhe harmoninë fetare dhe ndër-etnike mes të gjitha komuniteteve dhe anëtarëve të tyre.
4. Palët dakordohen t'i mbështesin plotësisht refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit në ushtrimin e të drejtave të tyre për t'u kthyer dhe kërkuar rikthimin në posedim të pronës dhe pasurisë personale në përputhje me ligjin.
5. Palët bien dakord që anëtarët e komuniteteve të kenë të drejtën për t'u shprehur lirshëm, promovuar dhe zhvilluar identitetin e tyre dhe atributet e komunitetit. Ushtrimi i këtyre të drejtave do të bartë në vete detyrat dhe përgjegjësitë për të vepruar në përputhje me ligjet e shtetit në të cilin ata banojnë dhe nuk do t'i shkelë të drejtat e të tjerëve.

Garancitë ligjore

1. Palët bien dakord që komuniteti serb në Republikën e Kosovës do vazhdojë të ketë të drejta specifike të garantuara në kornizën kushtetuese dhe ligjore të zbatueshme në Kosovë në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.
2. Palët bien dakordohen që për ndryshimin apo shfuqizimin e legjislacionit lidhur me interesat vitale të komunitetit serb në Republikën e Kosovës të kërkohet prania dhe votimi i shumicës së deputetëve të Kuvendit si dhe prania dhe votimi i shumicës së deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të garantuara për përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë.

Siguria

1. Palët pranojnë dhe dakordohen që secila Palë të ushtrojë autoritet të plotë dhe absolut mbi zbatimin e ligjit, sigurinë, drejtësinë, sigurinë publike, inteligjencën, reagimin ndaj emergjencave civile dhe kontrollin e kufijve në territorin e saj.

2. Autoritetet e Palëve për zbatim të ligjit do të bashkëpunojnë drejtpërsëdrejti, do të shkëmbejnë informata, do të angazhohen në operacione dhe hetime të përbashkëta, në trajnime të përbashkëta, në shkëmbime të zyrtarëve ndërlidhës dhe në forma të tjera të bashkëpunimit policor.
3. Palët do të përmbahen nga akte që pengojnë ose kanë për qëllim të pengojnë kontaktet ndërmjet anëtarëve të të njëjtit komunitet brenda një shteti dhe do të marrin masa afirmative për të krijuar dhe mbajtur kontakte të lira dhe paqësore me persona të të njëjtit komunitet në shtetin tjetër, veçanërisht me ata me të cilët ndajnë të njëjtin identitet etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar, ose një trashëgimi të përbashkët kulturore, në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.
4. Republika e Kosovës zotohet të ketë një forcë policore që pasqyron karakterin shumetnik të shoqërisë së saj dhe parimet e barazisë gjinore dhe të të drejtave të njeriut të parapara në Kushtetutë. Përbërja etnike e policisë brenda një komune do të pasqyrojë, për aq sa është e mundur, përbërjen etnike të popullsisë në atë komunë.
5. Në komunat ku komuniteti serb është komuniteti më i madh etnik në Republikën e Kosovës, komandantët e stacioneve policore dhe komandantët e nënstacioneve do të emërohen nga Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të propozimit nga Kuvendi Komunal dhe Drejtori i Përgjithshëm.
6. Kosova dakordohet që komandantët e stacioneve lokale do të informohen paraprakisht për operacione nga forcat policore qendrore ose speciale brenda perimetrit të stacioneve policore lokale, përveç nëse kërkohet ndryshe për shkak të rrethanave operacionale.
7. Palët bien dakord që në Republikën e Kosovës të themelohet një Këshill i Sigurisë, si organ këshillimor i kryesuar nga Kryetari i Komunës, përfaqësuesit komunalë dhe policorë, duke përfshirë edhe komandantët e stacionit, dhe me anëtarësi që përfaqëson të gjitha komunitetet brenda komunës.

Të drejtat dhe mbrojtjet fetare dhe kulturore

1. Republika e Kosovës do të sigurojë autonominë dhe mbrojtjen e të gjitha besimeve fetare dhe objekteve të tyre brenda territorit të saj.
2. Palët njohin të drejtën e komuniteteve për të përdorur dhe shfaqur simbolet e tyre, në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.

3. Republika e Kosovës bie dakord të promovoj dhe të mbështesë trashëgiminë kulturore dhe fetare të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës do të ketë një detyrë të veçantë për të siguruar mbrojtjen efektive të objekteve dhe monumenteve me rëndësi kulturore dhe fetare për komunitetin serb.
4. Republika e Kosovës bie dakord që Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, duke përfshirë klerin dhe bashkëpunëtorët e saj, aktiviteteve dhe pronës t'u ofrohet siguri shtesë dhe mbrojtje të tjera për gëzimin e plotë të të drejtave, privilegjeve dhe imuniteteve siç përcaktohen me ligj.

Pjesëmarrja e komunitetit serb në jetën publike në Republikën e Kosovës

1. Republika e Kosovës mbështet të drejtën e komunitetit serb që t'i regjistrojnë emrat personal në formën e tyre origjinale dhe sipas shkrimit në gjuhën së tyre si dhe të drejtën për t'i kthyer emrat origjinalë që janë ndryshuar kundër vullnetit të tyre.
2. Republika e Kosovës mbështet të drejtën e minoritetit serb për t'i përdorur emrat lokalë, emrat e rrugëve dhe treguesit e tjerë topografikë që pasqyrojnë dhe që janë të ndjeshëm ndaj karakterit shumetnik dhe shumëgjuhësh të asaj zone.
3. Republika e Kosovës dakordohet që të përmbahet nga çdo veprim që do ta pengonte komunitetin serb t'i gëzojnë kontaktet me organizatat joqeveritare lokale, rajonale dhe ndërkombëtare si dhe të marrin pjesë në aktivitetet këtyre organizatave.
4. Komuniteti serb i Kosovës dhe pjesëtarët e tij do të kenë të drejtën e përfaqësimit të barabartë në punësim në organet publike dhe në ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, duke përfshirë në veçanti shërbimin policor në zonat e banuara nga komuniteti i tillë, në të njëjtën kohë duke respektuar rregullat në lidhje me kompetencën dhe integritetin që rregullojnë administratën publike.
5. Komuniteti serb i Kosovës do të ketë të drejtën t'i mbajë dhe t'i përdorë mediat e veta, duke përfshirë të drejtën për të ofruar informacion në gjuhën e tij dhe për të përdorur një numër të rezervuar të frekuencave për mediat elektronike në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.

Pjesëmarrja e komunitetit serb në nivel qendror

1. Kosova dakordohet që partitë politike, koalicionet, iniciativat e qytetarëve dhe kandidatët e pavarur që janë vetë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës do të vazhdojnë të kenë numrin e përgjithshëm të vendeve të fituara përmes zgjedhjeve të hapura, me një minimum prej dhjetë (10) vendeve të garantuara nëse numri i vendeve të fituara është më pak

se dhjetë (10).

2. Republika e Kosovës dakordohet që në Kuvendin e Republikës së Kosovës një (1) zëvendëskryetar i Kuvendit t'i takojë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet e garantuara për komunitetin serb.
3. Republika e Kosovës do ta mbajë Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve si komision të përhershëm të Kuvendit për të siguruar që të drejtat dhe interesat e komuniteteve të trajtohen në mënyrë adekuate gjatë procesit legjislativ.
4. Republika e Kosovës dakordohet të mbajë Këshillin Konsultativ për Komunitete që vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në të cilin do të përfaqësohen të gjitha komunitetet.
5. Do të jetë të paktën një (1) ministër nga komuniteti serb i Kosovës në Qeverinë e Republikës së Kosovës.
6. Do të jenë të paktën dy (2) zëvendësministra nga komuniteti serb i Kosovës në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Nëse ka më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, do të jetë një zëvendësministër i tretë që përfaqëson komunitetin serb të Kosovës.
7. Republika e Kosovës dakordohet që për vendimet lidhur me propozimin e dy (2) gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të kërkohet shumica e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe votojnë, por vetëm me pëlqimin e shumicës së deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në Kosovës.
8. Republika e Kosovës dakordohet që dy (2) anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të zgjidhen nga deputetët e Kuvendit që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe që të paktën njëri nga të dy të jetë gjyqtar.
9. Republika e Kosovës dakordohet që së paku pesëmbëdhjetë për qind (15%) e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por jo më pak se tre (3) gjyqtarë, të jenë nga komunitetet jo-shumicë në Republikën e Kosovës.
10. Republika e Kosovës dakordohet që të paktën (15%) e vendeve të përgjithshme në Gjykatën e Apelit, por në asnjë rast më pak se dy (2) vende, t'u garantohen gjyqtarëve nga komunitetet jo-shumicë në Republikën e Kosovës.
11. Republika e Kosovës dakordohet që kandidatët për pozita gjyqësore në kuadër të gjykatave themelore, kompetenca e të cilave përfshin ekskluzivisht territorin e një ose më shumë

komunave në të cilat shumica e popullatës i përket komunitetit serb të Kosovës, mund të rekomandohen për emërim vetëm nga dy anëtarët e Këshillit të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit që mbajnë vendet e garantuara për komunitetin serb në Republikën e Kosovës, duke vepruar bashkërisht dhe në mënyrë unanime.

12. Republika e Kosovës dakordohet që një (1) anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të emërohet nga deputetët e Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për komunitetin serb të Kosovës.

Pjesëmarrja në nivel lokal

1. Republika e Kosovës bie dakord që në komunat ku të paktën dhjetë për qind (10%) e banorëve i përkasin komuniteteve jo-shumicë në ato komuna, një post i nënkryetarit të Kuvendit Komunal për komunitete të rezervohet për një përfaqësues të këtyre komuniteteve.
2. Republika e Kosovës dakordohet që nënkryetari për komunitete në nivel lokal do të promovojë dialogun mes komuniteteve dhe do të shërbejë si pikë zyrtare fokale për trajtimin e shqetësimeve dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë në mbledhjet e Kuvendit Komunal gjatë punimeve të tij. Nënkyetari gjithashtu do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e pretendimeve nga komunitetet ose pjesëtarët e tyre se aktet ose vendimet e Kuvendit Komunal shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Nënkyetari do t'i referojë këto çështje në Kuvendin Komunal për rishqyrtim të aktit ose të vendimit.
3. Në rast se Kuvendi Komunal vendos të mos e rishqyrtojë aktin ose vendimin e tij, ose nëse zëvendëskryetari konsideron se rezultati, pas rishqyrtimit, ende paraqet shkelje të një të drejte të garantuar me Kushtetutë, nënkryetari mund ta paraqesë çështjen drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do ta pranojë apo jo çështjen për shqyrtim.
4. Republika e Kosovës bie dakord që, në komunat ku së paku dhjetë për qind (10%) e banorëve i përkasin komuniteteve jo-shumicë, të garantohet përfaqësimi për komunitetet jo-shumicë në organin ekzekutiv komunal.

Kapitulli 4: Ekonomia

Lëvizja e lirë e njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit

1. Palët janë të vetëdijshme se angazhimi për lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit përbën një faktor kyç në zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit midis Palëve, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal dhe integrimin evropian.
2. Palët zotohen të bashkëpunojnë dhe të mbajnë marrëdhënie të mira fqinjësore lidhur me lëvizjen e njerëzve, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët në një gamë të gjerë fushash.
3. Secila Palë dakordohet që qytetarët e shtetit të saj do të kenë të drejtë të kërkojnë punësim në tregun e punës të shtetit tjetër.
4. Palët zotohen të ofrojnë të njëjtën ndihmë nga zyra kombëtare e punësimit dhe t'i trajtojnë shtetasit e shtetit tjetër si shtetas të shtetit mikpritës, pa asnjë diskriminim në bazë të shtetësisë ose kombësisë.
5. Secila Palë bie dakord t'i thjeshtësojë procedurat për lejet e qëndrimit dhe lejet e punës në përputhje me standardet e zbatueshme të secilës Palë.

Tregtia

1. Palët zotohen për tregti të lirë, në përputhje me procesin e integritit në Bashkimin Evropian dhe në përputhje me parimet përkatëse të Organizatës Botërore të Tregtisë ("OBT"), të cilat do të zbatohen në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese.
2. Palët zotohen për promovimin e marrëdhënieve ekonomike harmonike me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit në të gjitha fushat e tregtisë që janë të interesit të përbashkët.
3. Palët zotohen për heqjen e të gjitha barrierave ndaj lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve, njerëzve dhe kapitalit, dhe në veçanti zotohen që:
 - 3.1 Të heqin rregulloret e ndryshme kombëtare mbi standardet e produktit të cilat nuk paraqesin kërcënim ndaj shëndetit dhe që kanë efektin e bllokimit të importeve.
 - 3.2 Të ndryshojnë rregullat mbi themelimin të cilat obligojnë kompanitë që të kalojnë nëpër procedura të gjata dhe të shtrenjta aplikimi për të krijuar operacione.
 - 3.3 Të eliminojnë programet qeveritare të prokurimit me anë të të cilave qeveritë diskriminojnë në favor të kompanive kombëtare.

- 3.4 Të eliminojnë rregulloret qeveritare që vendosin kompanitë e njërit shtet në një disavantazh konkurrues përballë kompanive të shtetit tjetër.
- 3.5 Të eliminojnë rregulloret dhe praktikatat që kanë efektin e dhënies së subvencioneve shtetërore të eksportit.
- 3.6 Të hartojnë legjislacion që parasheh mbrojtjen e pronësisë (patentën adekuate, të drejtat e autorit, dhe regjimet e markës tregtare si dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale).
- 3.7 Të eliminojnë barrierat ndaj shërbimeve të ofruara nga institucionet financiare të njërit shtet në territorin e shtetit tjetër.
- 3.8 Të miratojnë të gjithë legjislacionin e nevojshëm për të mbrojtur ndaj dhe parandaluar trajtimin diskriminues të investimeve të bëra nga shtetasit e njërit shtet në shtetin tjetër.
- 3.9 Të zbatojnë kornizën ligjore përkatëse që ndalon sjelljen në kundërshtim me parimin e konkurrencës të ndërmarrjeve shtetërore ose private që kufizojnë shitjen ose blerjen e mallrave ose shërbimeve në tregjet përkatëse të Palëve.

Borxhet e jashtme

1. Palët do të krijojnë një Komision të Përbashkët për të negociuar pjesën e Kosovës në borxhin ndërkombëtar të trashëguar nga ish-Republika Socialiste Federale të Jugosllavisë.
2. Palët bien dakord që pjesa e Republikës së Kosovës në borxhin ndërkombëtar që do të shpërndahet të përfshij, *inter alia*, borxhin ndaj Bankës Botërore, kreditorëve të Klubit të Parisit dhe atyre të Klubit të Londrës.
3. Palët do të përcaktojnë ndarjen e borxhit të jashtëm në marrëveshje me kreditorët përkatës duke iu referuar parimeve të përfshira në Marrëveshjen për Çështjet e Trashëgimisë (2001) të nënshkruar nga shtetet trashëgimtare të ish-Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë për ndarjen e borxhit sovran të trashëguar nga ish-Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë.

Dëmet financiare të pazgjidhura, pensionet dhe kursimet

1. Palët do të krijojnë një Komision të Përbashkët për të vlerësuar:
 - 1.1 Kontributin financiar të qytetarëve të Kosovës në Skemën Pensionale të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë;
 - 1.2 Kompensimin e kursimeve të qytetarëve të Kosovës në Sistemin Bankar ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë;
 - 1.3 Kompensimin e dëmeve të valutave të huaja të qytetarëve të Kosovës në Sistemin Bankar ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.
2. Palët bien dakord që Komisioni i Përbashkët të kryejë vlerësimin e kontributit pensional të qytetarëve të Kosovës dhe vlerësimin e dëmeve në Sistemin Bankar të Republikës Socialiste

Federative të Jugosllavisë në përputhje me parimet e përfshira në Marrëveshjen për çështje të trashëgimisë (2001) të arritur mes shteteve trashëguese të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe standardet e zbatueshme ndërkombëtare.

3. Komisioni i përbashkët, i mbështetur nga ekipe ekspertësh krijon mekanizma procedurale për zbatimin e procesit të kompensimit të parashtruar në paragrafin 1 (1.1 deri 1.3) të këtij kreu.
4. Palët bien dakord të krijojnë grupe të përbashkëta ekspertësh për të adresuar çështjet e pazgjidhura nga periudha 1989 deri 1999 në Kosovë, si më poshtë:
 - 1.1. Rënia e prodhimit vendor dhe e nivelit të zhvillimit ekonomik;
 - 1.2. Zvogëlimin e aktiviteteve ekonomike;
 - 1.3. Zvogëlimin e investimeve;
 - 1.4. Dëmet dhe humbjet e shkaktuara nga Ndërmarrjet Shoqërore (NSH-të);
 - 1.5. Tregjet e humbura, veçanërisht tregjet e eksportit;
 - 1.6. Shembja e sistemit financiar;
 - 1.7. Përkeqësimi i gjendjes sociale dhe rritja e varfërisë si rezultat i largimit të punëtorëve, uzurpimit dhe keq-menaxhimit të fondit pensional dhe shtesave të fëmijëve;
 - 1.8. Dëmet e shkaktuara në aktivitete tjera sociale përfshirë arsimin, shëndetësinë, shkencën, kulturën dhe sportin.

Kapitulli 5: Drejtësia Tranzicionale dhe Pajtimi

Dispozita të përgjithshme

1. Palët njohin rëndësinë e trajtimit të vuajtjeve të viktimave të luftës si parakusht i domosdoshëm për pajtim.
2. Palët bien dakord të krijojnë një 'Arkiv të Luftës' të përbashkët që do të mbledhë fakte të bazuara në dëshmi mbi humbjet në njerëz, viktimat e luftës, të burgosurit e luftës, viktimat e dhunës seksuale dhe dëmet tjera shoqërore dhe materiale. Palët bien dakord që të përfshijnë në këtë proces organizatat e shoqërisë civile, familjet e viktimave, komisionet ekzistuese dhe ato të sapokrijuara.
3. Palët marrin përsipër të ofrojnë mbështetje ligjore dhe institucionale dhe shërbime sociale për viktimat e luftës, si dhe mbështetje për organizatat me bazë në komunitet dhe grupet mbështetëse për vetë-ndihmesë në nivel lokal.
4. Palët zotohen të vazhdojnë të mbështesin organizatat e shoqërisë civile në promovimin e një kulture të tolerancës në çdo nivel të shoqërisë, duke përfshirë iniciativa për inkurajimin e arsimit të integruar.
5. Palët do të krijojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme në aspektin gjinor për t'u marrë me të kaluarën, e cila përfshinë një gamë të gjerë të iniciativave të drejtësisë tranzicionale për viktimat e dhunës seksuale.
6. Palët do të ndajnë hapësirë në secilin kryeqytet për ndërtimin e një memoriali për kujtimin e viktimave të luftës.

Krimet e luftës

1. Republika e Serbisë bie dakord të forcojë përpjekjet për hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës kundër komunitetit shqiptar dhe komuniteteve të tjera të Kosovës. Republika e Kosovës merr përsipër të zbatojë obligimet që dalin nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore të Dhomat e Specializuara të Kosovës.
2. Palët angazhohen të arrijnë Marrëveshje Bilaterale në lidhje me Ndihmën e ndërsjellë juridike, Ekstradimin dhe Transferimin e Procedurave ligjore me qëllim lehtësimin e bashkëpunimit ligjor ndërmjet agjencive përkatëse të zbatimit të ligjit për të përmirësuar shkëmbimin dhe transferimin e rasteve lidhur me procedurat aktuale gjyqësore, dhe për të iniciuar raste të reja sipas nevojës bazuar në disponueshmërinë e informacionit.

3. Palët bien dakord të krijojnë Grupe të Përbashkëta të Prokurorëve dhe Hetuesve Policorë bazuar në marrëveshjen për ndihmë të ndërsjellë juridike me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të informatave për të dyshuarit për krime lufte.

Personat e pagjetur

1. Palët, në përputhje me ligjet vendore dhe me normat e të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të drejtës humanitare ndërkombëtar, bien dakord në mirëbesim për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përcaktimin dhe shkëmbimin e informatave lidhur me identitetin, vendndodhjen dhe fatin e personave të pagjetur nga secila Palë.
2. Palët bien dakord që komisionet qeveritare për personat e pagjetur dhe autoritetet e mjekësisë ligjore do të zhvillojnë komunikim të drejtpërdrejtë gjatë ushtrimit të mandatit të tyre sa i përket fatit të personave të pagjetur.
3. Palët do të fuqizojnë institucionet e tyre përkatëse qeveritare dhe të sundimit të ligjit që janë të mandatuara për çështjen e personave të pagjetur, duke ju dhënë autoritet dhe resurse të nevojshme për të ruajtur dhe intensifikuar këtë dialog si dhe për të siguruar bashkëpunim aktiv.
4. Palët bien dakord të bashkëpunojnë ngushtë me organizatat ndërkombëtare humanitare për sqarimin e fatit të personave të pagjetur dhe ofrimin e shërbimeve sociale për familjet e tyre.
5. Palët pranojnë të zbatojnë angazhimet e dala nga Deklarata e Përbashkët për Personat e Pagjetur në Kuadër të Procesit të Berlinit në Samitin e Ballkanit Perëndimor 2018.

Reparacionet e luftës

1. Secila palë bie dakord të angazhohet në hartimin dhe krijimin e skemave të kompensimit për krimet e kryera ndaj qytetarëve të Palës tjetër gjatë luftës, duke përfshirë viktimat e luftës dhe dëmet materiale.
2. Palët marrin përsipër të krijojnë një komision të përbashkët për vlerësimin e dëmeve materiale dhe për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për skemat e kompensimit financiar.
3. Serbia do të angazhohet në mirëbesim me iniciativat e Kosovës për njohjen e vuajtjeve të viktimave të dhunës seksuale.

4. Palët do të bashkëpunojnë për të siguruar dëmshpërblim dhe kompensim të duhur për viktimat e luftës, me theks të veçantë për viktimat e dhunës seksuale dhe familjet e personave të pagjetur.

Kapitulli 6: Arsimit dhe rinia

1. Palët bien dakord që plan-programet e arsimit publik serb të integrohen zyrtarisht në plan-programet e arsimit të Kosovës. Palët bien dakord të krijojnë grupe punuese të përbashkëta të cilat do të bëjnë çdo rishikim dhe përshtatje të nevojshme në tekstet shkollore dhe në plan-programet që kërkohet për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.
2. Shkollat që mbajnë mësim në gjuhën serbe mund të përdorin plan-programe ose tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë pas njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës.
3. Në rast të kundërshtimit nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës në lidhje me përdorimin e një plan-programi apo teksti të caktuar shkollor, çështja do t'i referohet një komisioni të pavarur për të shqyrtuar plan-programin ose tekstin shkollor në fjalë për të siguruar përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin përkatës.
4. Palët bien dakord që Universiteti i Mitrovicës Veriore të jetë një institucion publik autonom i arsimit të lartë. Universiteti do të nxjerrë një statut që specifikon organizimin dhe qeverisjen e brendshme të tij si dhe procedurat dhe ndërveprimin me autoritetet publike, në përputhje me legjislacionin qendror kornizë të Republikës së Kosovës, gjë që do të shqyrtohet nga një komision i pavarur. Financimi i universitetit nga qeveria e Republikës së Serbisë duhet të behet në mënyrë transparente dhe të bëhet publik, në përputhje me ligjet e Kosovës.
5. Të gjitha komunat në të cilat komuniteti serb i Kosovës është shumicë, do të kenë autoritet për të ushtruar përgjegjësi në lidhje me çështjet kulturore, duke përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore serbe brenda territorit të komunës, si dhe për mbështetjen e komuniteteve lokale kulturore.
6. Palët bien dakord që të rinjtë të kenë kontakte të pa penguara me, dhe të marrin pjesë pa diskriminim në shkëmbime akademike, kulturore, sportive dhe profesionale në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.
7. Palët bien dakord të krijojnë kushte të favorshme si dhe programe, iniciativa dhe aktivitete tjera mbështetëse që nxisin zhvillimin dhe shkëmbimin e artistëve, mësimdhënësve, atletëve, studentëve, të rinjve dhe udhëheqësve të ardhshëm.
8. Palët bien dakord të krijojnë skema financimi për krijimin e shkollave të përbashkëta ku nxënësit shqiptar dhe serb të Kosovës do të mësojnë së bashku.

9. Palët bien dakord të njohin brenda territorit të tyre përdorimin, nga pakica/komuniteti, e gjuhës dhe alfabetit të tyre lirisht si privatisht ashtu edhe në publik.

Kapitulli 7: Simbolet kombëtare

1. Palët bien dakord që të respektojnë flamurin, vulën, himnin, emblemën dhe simbole tjera shtetërore dhe kombëtare të palës tjetër. Palët bien dakord të lejojnë përdorimin e simboleve shtetërore pa penguar njëra-tjetrën në ngjarje rajonale dhe ndërkombëtare.
2. Komunitet në të cilat komuniteti serb i Kosovës është shumicë, mund të përdor simbolet e tyre, duke përfshirë stemat, vulat dhe emblemat, me kusht që simbolet e tilla të mos i ngjajnë simboleve të shteteve ose komunave të tjera brenda ose jashtë Republikës së Kosovës.
3. Asgjë në këtë kapitull nuk i ndalon autoritetet e Republikës së Kosovës nga përdorimi i simboleve shtetërore në çdo pjesë të territorit të saj.

Kapitulli 8: Asociacioni i komunave me shumicë serbe

1. Republika e Kosovës, në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuar në këtë Kapitull, do të themelon Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.
2. Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të themelohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Marrëveshjen e Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve të nënshkruar nga Kosova dhe Serbia më 19.04.2013, aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës Nr. KO130/15, dhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.
3. Asociacioni do të ketë statutin e vet, i cili përcakton objektivat e tij, strukturën dhe burimet e financimit.
4. Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të themelohet brenda kuptimit të nenit 44 (Liria e Asociimit) të Kushtetutës së Kosovës, dhe ligjit në fuqi përkitazi me lirinë e asociimit.
5. Statuti i Asociacionit, para se të hyj në fuqi, do të referohet në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për shqyrtim.
6. Palët pranojnë se gjykata kompetente e Kosovës mund të ndalojë çdo funksion ose aktivitet të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nëse funksionet dhe/ose aktivitetet e tilla kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare.

Kapitulli 9: Transporti

Transporti i përgjithshëm

1. Palët bien dakord të pranojnë dokumentet e identifikimit të lëshuara qytetarëve të dy palëve përfshirë pasaportën, dokumentin e identifikimit dhe patentën e shoferit.
2. Palët bien dakord të lejojnë udhëtimin e qytetarëve në automjetet e tyre me simbolet kombëtare të secilës palë.
3. Palët bien dakord të krijojnë komunikim të drejtpërdrejtë dhe shkëmbim të informatave mes policisë kufitare dhe doganave me qëllim zvogëlimin e pengesave të udhëtimit për qytetarëve.
4. Republika e Serbisë pranon të lejojë automjetet e vendeve të treta të udhëtojnë për në Kosovë dhe nga Kosova përmes Serbisë pa pengesë.

Hekurudhat

1. Palët pranojnë që infrastruktura hekurudhore brenda territorit të Republikës së Kosovës do të menaxhohet nga institucionet rregullatore të hekurudhave të Republikës së Kosovës. Palët pranojnë të drejtën legjitime të Kosovës për t'u bërë anëtare e organizatave hekurudhore evropiane dhe ndërkombëtare.
2. Palët bien dakord të investojnë në infrastrukturën hekurudhore dhe të dizajnojnë linja të reja për të mundësuar që mallrat dhe qytetarët e shteteve të lëvizin lirshëm.
3. Palët marrin përsipër të integrojnë sistemin hekurudhorë brenda rrjetit rajonal për Ballkanin Perëndimor dhe të krijojnë lidhje me Bashkimin Evropian

Kapitulli 10: Energjia

1. Palët pranojnë dhe njohin se secila prej tyre është palë e veçantë në Traktatin themelues të Komunitetit të Energjisë në Evropën Juglindore dhe se secila përfaqësohet në mënyrë të barabartë dhe të pavarur në procedurat, organet dhe forumet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe në organet dhe organizatat tjera ndërkombëtare pa kufizime. Secila nga Palët pajtohet që nuk do të përpiqet të kufizojë ose pengojë ushtrimin nga ana e Palës tjetër të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin prej saj.
2. Palët pranojnë që secila synon dhe punon drejt zbatimit të *acquis communautaire* të BE-së.
3. Palët bien dakord që secila do të ndërmarrë dhe do të bëjë që të ndërmerren të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes së Energjisë (2013) dhe Përfundimeve e lehtësuesit të BE-së për zbatimin e Marrëveshjes së Energjisë 2013 (2015).
 - 3.1. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) do të funksionojnë si Zonë/Blok i Pavarur i Kontrollit brenda Evropës Kontinentale. Republika e Serbisë bie dakord të ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme në mënyrë që KOSTT të funksionojë si Zonë/Blok i Pavarur i Kontrollit në Evropën Kontinentale dhe do të largojë dhe heq dorë nga të gjitha mjetet, instrumentet, barrierat administrative e ligjore brenda ENTSO-E dhe mekanizmave e organeve tjera Evropiane.
4. Palët pranojnë se ekziston një mosmarrëveshje e hapur për transmetimin e energjisë ndërmjet Republikës së Kosovës (KOSTT) dhe Republikës së Serbisë (EMS). Palët bien dakord që paratë dhe të hyrat e mbledhura nga EMS që nga viti 2007, që i atribuohen linjave të interkoneksionit të transmetimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe vendeve fqinje (Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi) siç është përcaktuar dhe konfirmuar nga Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) dhe/ose ENTSO-E, do t'i transferohen KOSTT-it menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje. Të gjitha të hyrat dhe paratë nga kompensimi i Mekanizmit Ndër-OST që i atribuohet KOSTT-it, të cilat janë mbledhur nga EMS që nga viti 2004, do t'i transferohen KOSTT-it siç është përcaktuar dhe konfirmuar nga ACER dhe/ose ENTSO-E.

Kapitulli 11: Zbatimi i marrëveshjeve të Brukselit

Dispozitat e përgjithshme

1. Palët riafirmojnë marrëveshjet e mëposhtme të arritura ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë në dialogun teknik dhe në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve të lehtësuara nga Bashkimi Evropian:

Dialogu për normalizim të marrëdhënieve

- 1.1 Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, nënshkruar më 19 prill 2013
- 1.2 Marrëveshja për Drejtësinë, nënshkruar më 9 shkurt 2015
- 1.3 Liria e lëvizjes/Konkluzionet për urën, nënshkruar më 25 gusht 2015
- 1.4 Përfundimet e lehtësuesit të BE-së për zbatimin e Marrëveshjes së Energjisë të vitit 2013, nënshkruar më 25 gusht 2015
- 1.5 Plani i BE-së për Zbatimin e Marrëveshjes për Urën e Mitrovicës, nënshkruar më 5 gusht 2016.

Dialogu teknik

- 1.1 Regjistrat civil, nënshkruar më 2 korrik 2011
 - 1.2 Liria e lëvizjes, nënshkruar më 2 korrik 2011
 - 1.3 Vulat doganore, nënshkruar më 2 shtator 2011
 - 1.4 Njohja e diplomave universitare, nënshkruar më 2 korrik 2011
 - 1.5 Menaxhimi i integruar i kufijve, nënshkruar më 2 dhjetor 2011
 - 1.6 Protokollu teknik për zbatimin e MIK-së, nënshkruar më 23 shkurt 2011
 - 1.7 Përfaqësimi dhe bashkëpunimi rajonal, nënshkruar më 24 shkurt 2011
 - 1.8 Mbledhja e të hyrave të doganave, nënshkruar më 14 dhjetor 2012
 - 1.9 Marrëveshjet e ndërlidhjes, nënshkruar në maj 2013
 - 1.10 Marrëveshja për energjinë, nënshkruar më 8 shtator 2013
 - 1.11 Marrëveshja për telekomunikime, nënshkruar më 8 shtator 2013
 - 1.12 Marrëveshja për shpërbërjen e mbrojtjes civile, nënshkruar më 26 mars 2015
 - 1.13 Njohja reciproke e certifikatave ADR, nënshkruar më 19 prill 2016
2. Palët riafirmojnë angazhimin e tyre për zbatim të plotë të detyrimeve që dalin nga këto marrëveshje, përveç nëse parashihet ndryshe në këtë marrëveshje.
 3. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet marrëveshjeve të sipërpërmendura dhe kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mbizotërojnë.

Zgjedhjet

1. Palët bien dakord se zgjedhjet në komunat e veriut organizohen nga autoritetet zgjedhore të Republikës së Kosovës në pajtim me ligjet dhe rregulloret e Kosovës për zgjedhje.
2. Palët bien dakord të forcojnë përpjekjet e tyre për të siguruar që zgjedhjet në komunitetin serb përmbushin standardet e aplikueshme ndërkombëtare për zgjedhje të lira, të drejta dhe konkurruese.

Përfaqësimi i Kosovës në Forume Ndërkombëtare

Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, palët pranojnë shfuqizimin e Marrëveshjes për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal (2011).

Policia e Kosovës

Palët riafirmojnë përkushtimin e tyre për të vazhduar me zbatimin e detyrimeve që dalin nga marrëveshja për Policinë e Kosovës.

Mbrojtja Civile

Palët riafirmojnë përkushtimin e tyre për të vazhduar me zbatimin e detyrimeve që dalin nga marrëveshja për Mbrojtjen Civile.

Themelimi i Misioneve të Përhershme Diplomatike

1. Palët bien dakord të themelojnë misione të përhershme diplomatike në shtetin e palës tjetër. Palët bien dakord të sigurojnë përputhshmëri me normat ndërkombëtare për themelim të marrëdhënieve diplomatike.
2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, palët pranojnë shfuqizimin e marrëveshjes për ndërlidhje.

Telekomunikacioni

1. Palët pranojnë se Republika e Kosovës do të bëhet anëtare e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikimeve (ITU) me njohjen e të gjitha kredencialeve shtetërore përfshirë radio sinjalet, ndarjet rajonale të frekuencave, numrin ndërkombëtar për telekomunikacion dhe shërbime tjera relevante.

2. Palët pranojnë se Republika e Kosovës do të bëhet anëtare e Unionit Postar Universal (UPU) dhe do të marrë kode postare për Kosovën të cilat janë të njohura ndërkombëtarisht.
3. Palët pranojnë se Kosova do të futet në listën e divizionit statistikor të OKB-së, gjë që do t'i mundësojë Republikës së Kosovës listimin në ISO standardin 3166 si parakusht për marrjen e domenit të nivelit të lartë të internetit (kodi i vendit i internetit) nga ICANN dhe marrjen në mënyrë direkte të IP adresave të internetit nga RIPE. Listimi në këtë ISO standard (3166) do të zgjidhë automatikisht praninë digjitale të Kosovës si shtet i pavarur në internet.
4. Palët bien dakord të koordinohen sa i përket radio-frekuencave ndërkufitare për të gjitha brezat e frekuencave bazuar në standardet përkatëse ndërkombëtare.
5. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, do të shpërbëhen operacionet e paautorizuara të Postës së Serbisë në Kosovë.

Dogana

1. Palët riafirmojnë përkushtimin e tyre për të vazhduar me zbatimin e detyrimeve që dalin nga marrëveshja për doganat.
2. Palët bien dakord që vulat doganore të rregullohen në përputhje me Përfundimet e dakorduara mbi Vulat Doganore/Tregtinë e Lirë (02 shtator 2011).
3. Palët bien dakord që mbledhja e tarifave doganore nga Dogana e Kosovës në komunat veriore me shumicë serbe do të bëhet në përputhje me Marrëveshjen për Mbledhjen e të Hyrave Doganore (17 janar 2013).

Menaxhimi i integruar i kufijve

Palët riafirmojnë përkushtimin e tyre për të vazhduar me zbatimin e detyrimeve që dalin nga marrëveshja për Menaxhimin e Integruar të Kufijve.

Kapitulli 12: Mekanizmat zbatues dhe monitorues

1. *Palët bien dakord se Garantues të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Franca, Italia dhe Bashkimi Evropian.*
2. *Garantuesit e kësaj marrëveshjeje, pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të bëjnë përpjekje të vazhdueshme substanciale për përafrimin e shteteve që nuk kanë njohur Kosovën.*
3. *Palët pranojnë që me qëllim të lehtësimit të monitorimit dhe zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të themelohet një Komision i Përbashkët Monitorues i përbërë nga përfaqësues të garantuesve të kësaj Marrëveshjeje.*
4. *Komisioni i Përbashkët Monitorues, për qëllim të monitorimit dhe mbledhjes së fakteve duhet të ketë prezencë në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Serbisë.*
5. *Palët pranojnë se garantuesit mund të vendosin Rregulla dhe Procedura të tilla në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.*
6. *Komisioni i Përbashkët Monitorues çdo tre muaj do të përgatis një raport që vlerëson zbatimin e Marrëveshjes nga Palët.*
7. *Palët bien dakord që avancimi i procesit të integritit në BE do të kushtëzohet me vlerësimin e kënaqshëm të zbatimit të Marrëveshjes siç përcaktohet në pikën 4 të këtij kapitulli.*
8. *Palët bien dakord që gjetjet e raporteve të Komisionit të Përbashkët Monitorues mund të pasqyrohen në Raportet e Bashkimit Evropian për Shtetet përkatëse.*
9. *Palët do të përmbahen nga bllokimi i njëra-tjetrës në përpjekjet e tyre përkatëse drejt procesit të integritit në BE.*

Kapitulli 13: Ndryshimet në Kornizën ligjore

1. Palët do të sigurojnë që të bëjnë përshtatjet e nevojshme në kornizat përkatëse ligjore për të akomoduar këtë Marrëveshje.
2. Ndryshimet në kornizën ligjore të secilës Palë do të jenë në përputhje me këtë marrëveshje dhe me vendime e mundshme, nëse ka, që rrjedhin nga proceset e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Kapitulli 14: Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve sipas kësaj Marrëveshje

1. Nëse lind ndonjë mosmarrëveshje midis palëve përkitazi me interpretimin, zbatimin ose përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, secila palë mund të paraqesë mosmarrëveshjen në arbitrazh përfundimtar dhe të detyrueshëm në përputhje me Rregullat Opsionale të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve midis Dy Shteteve, që hyn në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.
2. Numri i arbitrave do të jetë pesë.
3. Gjuha që do të përdoret në procedurën e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.
4. Autoriteti i emërimit është Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit.
5. Vendi i arbitrazhit do të jetë Hagë, Holandë.

Kapitulli 15: Njohja dhe Anëtarësimi në Organizata Ndërkombëtare

- 1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët dhe Garantuesit bien dakord që të iniciojnë procedurën për miratimin e një Rezolutive të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që njeh këtë Marrëveshje dhe pranon që Kosova të jetë anëtare e plotë e Kombeve të Bashkuara.*
2. Palët bien dakord që të mos bllokojnë ose inkurajojnë të tjerët që të bllokojnë anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë por pa u kufizuar në Bashkimin Evropian, Këshillin e Evropës, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

Kapitulli 16: Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përmbushjes së suksesshme të kushteve sipas rendit specifik të përcaktuar më poshtë:

1.1 Ratifikimi nga Parlamentet e të dy Palëve.

1.2 Depozitimi i instrumenteve të ratifikimit në Sektorin e Traktateve të Zyrës për Çështje Ligjore të Kombeve të Bashkuara në pajtim me Nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.